



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 30.05.2023)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm për një pozicion të lirë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 13:16 dhe mbaroi në orën 15:14.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 4. Irena Plaku | (anëtare) |
| 5. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 6. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 7. Alban Toro | (anëtar) |
| 8. Marçela Shehu | (anëtare) |
| 9. Brikena Ukperaj | (anëtare) |

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

2. Luan Dibra, Gentiana Agushi, Maela Alicantaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

3. Valbona Bala, Eksperte (EWMI-NL)

4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.

5. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.

6. Edmond Hoxhaj, BIRN.

RENDI I DITËS:

I. Shqyrtimi i projektvendimit “Për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm për një pozicion të lirë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

Ilir Rusi: Përsëritje të nderuar anëtarë, paraprakisht ju njoftoj që mbledhja e ditës së sotme do të drejtohet nga unë Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, Ilir Rusi, për shkak se Kryetarja zonja Llagami, për arsye objektive e ka të pamundur për të qenë prezent në këtë mbledhje.

Sipas rendit të ditës kemi disa çështje për të trajtuar dhe në raport me natyrën e tyre kemi menduar për t’i trajtuar jo në mënyrë kronologjike siç janë renditur në rendin e ditës, por sipas natyrës së tyre dhe për shkak se kemi disa çështje me dyer të mbyllura për të diskutuar.

Fillimisht fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës që është shqyrtimi i projektvendimit “Për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm për një pozicion

të lirë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë”, për të cilin është përgatitur relacioni. Për më tej fjalën relatorit z. Toro.

Alban Toro: Faleminderit!

Më herët me vendimin nr. 202, datë 31.05.2022 nga ana e Këshillit është vendosur transferimi i gjyqtarit {...}, aktualisht gjyqtar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë. Ky transferim është bërë për shkak të nevojave imediate dhe ngarkesës relativisht të madhe që ka pasur kjo gjykatë e cila sipas dekretit nr. 7818, datë 16.11.2012, i ndryshuar, organikën e ka: Struktura Organizative 4 gjyqtarë: Organika në fakt: 4 gjyqtarë; Efektivisht në detyrë: 3 gjyqtarë.

Kjo gjykatë ka një ngarkesë relativisht shumë të madhe krahasuar me gjykatën nga ku ka caktim të përhershëm z. {...}, ka 1372 çështje Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë, ndërkohë që Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastrë ka 190 çështje gjyqësore.

Në këtë kuadër, e vetmja skemë e cila na vjen në ndihmë është ajo e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, për të cilin është bërë edhe ky relacion dhe pikërisht në aktin tonë rregullativ, në referim të vendimit nr.23, datë 07.02.2019 është parashikuar ndër të tjera që “Thirrja për aplikim pasi publikohet në faqen e internetit fillimisht i drejtohet gjyqtarit i cili aktualisht është në transferim”.

Duke qenë që aktualisht ne presim që më datë 1 qershor (*fillon funksionimin më datë 1 korrik*) të funksionojë Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Lushnjë, është përcaktuar që periudha e komandimit/e transferimit të zgjasë deri më 30.06.2023.

Në këtë aspekt është përgatitur projektvendimi ku në dispozitiv ju sugjerohet të miratoni:

1. Të shpallë një pozicion të lirë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë për transferim të përkohshëm deri më datë 30.06.2023.

2. Kjo shpallje i drejtohet gjyqtarit të transferuar, aktualisht në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, z. {...}, i cili ftohet për të dhënë pëlqimin për përsëritjen e transferimit të përkohshëm.

3. Afati për dhënien e pëlqimit të jetë brenda ditës nga njoftimi i këtij vendimi.
4. Ngarkohet Komisioni i Zhvillimit të Karrierës për ndjekjen e hapave të mëtejshëm të procedurës së transferimit të përkohshëm.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Toro!

Ftoj anëtarët prezent në mbledhje nëse kanë diskutime.

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime po vazhdojmë me votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm për një pozicion të lirë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Të shpallë një pozicion të lirë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë për transferim të përkohshëm deri më datë 30.06.2023.
2. Kjo shpallje i drejtohet gjyqtarit të transferuar, aktualisht në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, z. {...}, i cili ftohet për të dhënë pëlqimin për përsëritjen e transferimit të përkohshëm.
3. Afati për dhënien e pëlqimit të jetë brenda ditës nga njoftimi i këtij vendimi.

4. Ngarkohet Komisioni i Zhvillimit të Karrierës për ndjekjen e hapave të mëtejshëm të procedurës së transferimit të përkohshëm.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Në vijim të mbledhjes vazhdojmë me çështjet të cilat janë me dyer të mbyllura për shkak të natyrës së tyre.

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 30.05.2023)

Pika 5 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtim i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 500 dhe nr. 501, datë 21.11.2022, si dhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale të shpallur me vendimin nr. 503, datë 21.11.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).¹

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 13:16 dhe mbaroi në orën 15:14.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 4. Irena Plaku | (anëtare) |

¹ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 11-ta sipas rendit të ditës.

5. *Dritan Hallunaj* (anëtar)
6. *Ridvan Hado* (anëtar)
7. *Alban Toro* (anëtar)
8. *Marçela Shehu* (anëtare)
9. *Brikena Ukperaj* (anëtare)
10. *Yllka Rupa* (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jasthtë.*
2. *Luan Dibra, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
3. *Valbona Bala dhe Oltia Lolo Eksperte (EWMI-NL).*
4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
5. *Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*
6. *Edmond Hoxhaj, BIRN.*

RENDI I DITËS:

5. Shqyrtim i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 500 dhe nr. 501, datë 21.11.2022, si dhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale të shpallur me vendimin nr. 503, datë 21.11.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Ilir Rusi: Vazhdojmë mbledhjen e sotme plenare me çështjet të cilat për shkak të natyrës së tyre diskutohen në mënyrë publike.

Vazhdojmë me shqyrtimin e projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 500 dhe nr. 501, datë 21.11.2022, si dhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale të shpallur me vendimin nr. 503, datë 21.11.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit z. Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit!

Me vendimin nr.500, datë 21.11.2022, Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosur:

“1. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë...”

Me vendimin nr. 501, datë 21.11.2022 Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur:

“1. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë...”

Me Vendimin nr. 503, datë 21.11.2022 Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur:

“1. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Durrës në fushën e të drejtës penale.”

Në këto procedura ngritjeje në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe në Gjykatën e Apelit Durrës, afati i kandidimit është përcaktuar dy javë nga dita e publikimit të vendimit përkatës në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Pikërisht në këto vende ka shfaqur interes dhe ka paraqitur kërkesën e tij z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë (Juridiksioni i Përgjithshëm Vlorë).

Pasi morëm kërkesën, në zbatim të detyrimeve ligjore KZHK-ja filloi verifikimin e kriterëve paraprake të kandidimit dhe nga ky verifikim kanë dalë këto rezultate.

Për kandidatin z. {...} u verifikua kriteri i “përvojës profesionale minimale”.

“Përvoja profesionale minimale” për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, gjen reflektim në shkronjën “a”, të pikës 5, të vendimeve të Këshillit nr. 500 dhe nr. 501, datë 21.11.2022, ku është parashikuar si kriter kandidimi, në nenin 47, pika 2, shkronja “a”, të Ligjit për Statusin.

“Përvoja profesionale minimale” për ngritjen në detyrë në gjykatën e shkallës së dytë në rastin konkret në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, gjen reflektim në shkronjën “a”, të pikës 5, të Vendimit të Këshillit nr. 503, datë 21.11.2022, ku është parashikuar si kusht kandidimi përcaktimi ligjor në nenin 47, pika 4, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: “Magjistrati mund të ngrihet në detyrë në pozicione pranë gjykatave ose prokurorive të shkallës së dytë, nëse ka ushtruar funksionin jo më pak se shtatë vjet në shkallën e parë, nga të cilat të paktën pesë vjet në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar”.

Në lidhje me përvojën e përgjithshme profesionale, në kërkesat për shprehje interesi dhe në jetëshkrimin e dorëzuar nga kandidati, evidentohet se ai ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2010, ndërkohë që ai është emëruar si gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, (stazhi profesional) për periudhën 27 shtator 2010 deri në 21 dhjetor 2011, ku ka gjykuar çështje me natyrë të përgjithshme. Në vijim ai është emëruar gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, ku vijon të ushtrrojë funksionin dhe aktualisht. Me vendim nr. 404, datë 07.10.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor caktohet për të shërbyer si pjesë e skemës së delegimit pranë Gjykatës së Apelit Vlorë, detyrë të cilën e ka ushtruar deri më 01.02.2023, kur u krijua Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjellë nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, kandidati z. {...}, ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli Jurist, pranë Universitetit të Tiranës në datë 08.07.2008 dhe ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2010.

Me dekretin nr. {...}, datë 27.09.2010 të Presidentit të Republikës ai caktohet për të kryer stazhin profesional pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Me dekretin nr. {...}, datë 21.12.2011 të Presidentit të Republikës emërohet gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Me vendimin nr. 404, datë 07.10.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor caktohet për të shërbyer si pjesë e skemës së delegimit pranë Gjykatës së Apelit Vlorë, për periudhën deri në datë 07.10.2021.

Me vendim nr. 413, datë 29.09.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor ricaktohet për të shërbyer si pjesë e skemës së delegimit pranë Gjykatës së Apelit Vlorë, për periudhën deri më datë 07.10.2022.

Me vendimin nr. 407, datë 04.10.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor ricaktohet për të shërbyer si pjesë e skemës së delegimit pranë Gjykatës së Apelit Vlorë, për periudhën deri më datë 01.02.2023 dhe në vijim ushtron funksionin e magjistratit (gjyqtar) pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Vjetërsia në ushtrimin e funksionit të magjistratit është 12 vite.

Z. {...} nuk ka masa disiplinore në fuqi.

Nga të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, kandidati, deri në momentin e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet e Këshillit nr. 500 dhe nr. 501, datë 21.11.2022 si dhe për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 503, datë 21.11.2022 rezulton të ketë mbi 10 (dhjetë) vjet përvojë të përgjithshme profesionale si gjyqtar në gjykatën e shkallës së parë dhe mbi 2 (dy) vjet përvojë të përgjithshme profesionale, si gjyqtar i skemës së delegimit pranë Gjykatës së Apelit Vlorë.

Informacionet në lidhje me çështjet e përfunduara janë pjesë e relacionit. Nuk po ndalem për ngarkesën sepse janë të gjitha të paraqitura në mënyrë tabelare.

Nga të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, z. {...}, deri në momentin e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimet e Këshillit nr. 500 dhe nr. 501, datë 21.11.2022 si dhe për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë të

shpallur me vendimin e Këshillit nr. 503, datë 21.11.2022, rezulton se ai ka mbi pesë vjet përvojë specifike profesionale në fushën e të drejtës penale.

Për kandidatin z. {...} u verifikua kriteri i “Dhënies së pëlqimit (ai/ajo edhe familjarët e afërm) për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”.

Në lidhje me këtë kriter, në rastin e aplikimit për Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, kandidati ka depozituar:

- Formularin “Vetëdeklarim (i gjyqtarëve dhe prokurorëve)”, Shtojca B, Deklarata 1, plotësuar dhe firmosur rregullisht nga kandidati, z. {...}, i datës 05.12.2022;

- Formularin “Vetëdeklarim (i anëtarëve të familjes së gjyqtarëve), deklarata sipas Shtojcës B, Deklarata 3, plotësuar dhe firmosur rregullisht nga bashkëshortja e tij, datë 05.12.2022.

Sa më sipër, rezulton se kandidati, dhe familjarët e tij të afërt, konkretisht bashkëshortja, në respektim të përcaktimeve ligjore, kanë dhënë pëlqimin e shprehur sipas formularëve përkatëse tip, për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit nr. 95/2016.

Për kandidatin z. {...} u verifikua edhe kriteri i “mospasjes masë disiplinore në fuqi”.

Është bërë verifikimi për pasjen ose jo të masës disiplinore dhe ka rezultuar se ai vetë ka depozituar formularin e Vetëdeklarimit “Për masa disiplinore” datë 05.12.2022, ku deklaron se nuk ka masë disiplinore në fuqi.

Sipas informacionit të përcjellë nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, ka rezultuar se z. {...} nuk ka asnjë masë disiplinore në fuqi.

Për kandidatin z. {...} u verifikua edhe kriteri i “papajtueshmërisë ambientale”.

Është një kriter i cili është përcaktuar në vendimet nr. 500, nr. 501, nr. 503, datë 21.11.2022, vendime të cilat janë mbështetur pikërisht në nenin 8, pika 2, të ligjit “Për statusin e gjyqtarit”.

Gjatë verifikimit në lidhje me këtë kriter nuk rezultoi ndonjë e dhënë e ndryshme nga ajo e deklaruar nga kandidati në lidhje me situatën e papajtueshmërisë ambientale, për sa ai kandidon për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm. Pra vetë kandidati ka bërë deklaratën që nuk do të ndodhet në situatën e papajtueshmërisë ambientale, njëkohësisht edhe nga verifikimet e bëra nga unë si relator ka rezultuar që nuk ka ndonjë të dhënë e cila mund të na bëjë ta zgjerojmë më tej verifikimin në lidhje me kriterin e situatës së papajtueshmërisë ambientale.

Duke e vlerësuar të plotë procedurën e verifikimit paraprak për kandidatin z. {...} në lidhje me kriteret formale të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallur me vendimet nr. 500 dhe nr. 501 datë 21.11.2022 si dhe për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 503 datë 21.11.2022, relatori i çështjes ia parashtrori verifikimet e bëra Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

Më pas në mbledhjen e datës 19.04.2023, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, duke konsideruar të plotë procedurën e verifikimit për kriteret formale të kandidimit të kandidatit të përmendur më lart, bazuar në Seksionin C, Kreu VI, të vendimit 75/2019, si dhe në pikën 9, të vendimeve të Këshillit nr. 501, nr. 501 dhe nr. 503, datë 21.11.2022, vendosi kalimin e çështjes për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor për të vlerësuar dhe vendosur për:

Verifikimin e plotësimin nga kandidati z. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 500, nr. 501 dhe nr. 503 datë 21.11.2022, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “dhënies së pëlqimit (ai edhe familjarët e afërm) për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet e Këshillit nr. 500 dhe nr. 501 datë 21.11.2022 si dhe për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 503, datë 21.11.2022.

Faleminderit!

Këto ishin propozimet tona.

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Kurushi!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 500 dhe nr. 501, datë 21.11.2022, si dhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale të shpallur me vendimin nr. 503, datë 21.11.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 500, nr. 501 dhe nr. 503, datë 21.11.2022, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “dhënies së pëlqimit (ai edhe familjarët e afërm) për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet e Këshillit nr. 500 dhe nr. 501, datë 21.11.2022 si dhe për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 503, datë 21.11.2022.

3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 5 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 30.05.2023)

Pika 6 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtim i projektvendimit “Për fillimin e procedurave të përzgjedhjes së kandidatëve për lëvizje paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë e Durrës për pozicionet e shpallura të lira, përkatësisht me vendimet nr. 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21 dhe 24, datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).²

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 13:16 dhe mbaroi në orën 15:14.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 4. Irena Plaku | (anëtare) |
| 5. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 6. Ridvan Hado | (anëtar) |

² Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 9-ta sipas rendit të ditës.

7. *Alban Toro* (anëtar)
8. *Marçela Shehu* (anëtare)
9. *Brikena Ukperaj* (anëtare)
10. *Yllka Rupa* (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
2. *Luan Dibra, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
3. *Valbona Bala dhe Oltia Lolo Eksperte (EWMI-NL).*
4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
5. *Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*
6. *Edmond Hoxhaj, BIRN.*

RENDI I DITËS:

6. Shqyrtim i projektvendimit “Për fillimin e procedurave të përzgjedhjes së kandidatëve për lëvizje paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë e Durrës për pozicionet e shpallura të lira, përkatësisht me vendimet nr. 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21 dhe 24, datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Ilir Rusi: për më tej vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës.

Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurave të përzgjedhjes së kandidatëve për lëvizje paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë e Durrës për pozicionet e shpallura të lira, përkatësisht me vendimet nr. 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21 dhe 24, datë 18.01.2023 të Këshillit të

Lartë Gjyqësor”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit z. Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit!

Në mbledhjen plenare të datës 18.01.2023, në ushtrim të funksionit kushtetues dhe ligjor për të siguruar mbarëvajtjen dhe administrimin e pushtetit gjyqësor, por edhe përgjegjësisë për të siguruar pavarësinë dhe përgjegjshmërinë e tij, me vendimet nr. 11; 12; 13; 14; 15; 16; 17; 18; 19; 20; 21; 22; 23 dhe 24, datë 18.01.2023 Këshilli i Lartë Gjyqësor hapi procedurat e lëvizjeve paralele në gjykatat e rrethit gjyqësor Tiranë e Durrës.

Brenda afatit të kandidimit u paraqitën gjithsej 36 (tridhjetë e gjashtë) kandidatura, të cilët kanë aplikuar në procedurat e lëvizjes paralele për pozicionet e lira në fushën civile në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë e Durrës të prezantuar si më sipër.

Këshilli me vendimin nr.77, datë 13.02.2023, miratoi listën e kandidatëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime, për efekt të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë e Durrës. Në këtë listë janë përfshirë gjithsej 14 (katërbëdhjetë) kandidatë.

Në vijim, me vendimin nr. 115, datë 13.03.2023, Këshilli ka vendosur: “I. Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë e Durrës, të shpallura me vendimet nr. 11 - 20, 21 dhe nr. 24; e vijues, datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatët që kanë ose mund të kenë 2 (dy) vlerësime. II. Caktimin e relatorit për secilin kandidat,”.

Mbas përfundimit të procedurave të verifikimit, deri më sot, Këshilli ka vendosur kualifikimin e 12 (dymbëdhjetë) kandidatëve dhe vijimin për ata të procedurave të lëvizjes paralele në gjykatën e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Tiranë e Durrës. Pra është bërë verifikimi i kriterëve formale dhe sot po paraqesim relacionin për të vijuar më tej me procedurat e lëvizjes paralele.

Për dy kandidatë, konkretisht për: i) z. {...} procedura u përfundua për shkak të tërheqjes së tij nga kandidimi dhe ii) znj. {...} procedura u përfundua pasi Këshilli me

vendimin nr. 218, datë 28.04.2023 ka vendosur: “Transferimin e znj. {...}, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në një pozicion të lirë në fushën e së drejtës civile, për shkak të suprimimit të pozicionit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat ku është caktuar në mënyrë të përhershme.”

Në lidhje me kandidatët që janë kualifikuar për lëvizjen paralele dhe për të cilët po vijon procedura e vlerësimit etik dhe profesional nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, janë si më poshtë:

- i. Z. {...}, i cili kandidon për pozicionet nr. 11 dhe nr. 24.
- ii. Z. {...}, i cili kandidon për pozicionet nr. 11 dhe nr. 12.
- iii. Znj. {...}, e cila kandidon për pozicionet nr. 12 dhe nr. 20.
- iv. Znj. {...} e cila kandidon për pozicionet nr. 12, nr. 17 dhe nr. 20.
- v. Z. {...}, i cili kandidon për pozicionet nr. 12, nr.13 dhe nr. 15.
- vi. Znj. {...}, e cila kandidon për pozicionet nr. 13 dhe nr.17.
- vii. Z. {...} i cili kandidon për pozicionin nr. 14.
- viii. Znj. {...} e cila kandidon për pozicionin nr. 15.
- ix. Z. {...} i cili kandidon për pozicionet nr. 16 dhe nr. 18.
- x. Z. {...}, cili kandidon për pozicionet nr. 17 dhe nr. 21.
- xi. Z. {...}, i cili kandidon për pozicionet nr. 18, nr.19 dhe nr. 20.
- xii. Znj. {...}, e cila kandidon për pozicionin nr. 18.

Sa i përket pozicioneve, tabloja me gjyqtarët e kualifikuar është si më poshtë:

Për pozicionin e shpallur me vendimin nr. 11 janë të kualifikuar z. {...} dhe z. {...}.

Për pozicionin e shpallur me vendimin nr. 12 janë të kualifikuar znj. {...}, z. {...}, znj. {...} dhe z. {...}.

Për pozicionin e shpallur me vendimin nr. 13 janë të kualifikuar znj. {...} dhe z. {...}.

Për pozicionin e shpallur me vendimin nr. 14 është i kualifikuar z. {...}.

Për pozicionin e shpallur me vendimin nr. 15 janë të kualifikuar znj. {...} dhe z. {...}.

Për pozicionin e shpallur me vendimin nr. 16 është i kualifikuar z. {...}.

Për pozicionin e shpallur me vendimin nr. 17 janë të kualifikuar z. {...}, znj. {...} dhe znj. {...}.

Për pozicionin e shpallur me vendimin nr. 18 janë të kualifikuar z. {...}, z. {...} dhe znj. {...}.

Për pozicionin e shpallur me vendimin nr. 19 janë të kualifikuar z. {...} dhe znj. {...} e cila siç e thamë, ne kemi marrë vendim për transferimin e kësaj gjyqtareje për shkak të suprimimit të përhershëm të pozicionit të saj në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat.

Për pozicionin e shpallur me vendimin nr. 20 janë të kualifikuar z. {...}, znj. {...} dhe znj. {...}.

Për pozicionin e shpallur me vendimin nr. 21 është i kualifikuar z. {...}.

Për pozicionin e shpallur me vendimin nr. 24 është i kualifikuar z. {...}.

Propozimi i Komisionit:

Sa më sipër, rezulton që në procedurat e lëvizjeve paralele në gjykatat e shkallëve të para të juridiksionit të përgjithshëm Tiranë e Durrës, të ketë kandidatë të kualifikuar transferim nëpërmjet lëvizjes paralele, ku shumica e të cilëve kanë kandiduar për tre pozicione të lira, në bazë të së drejtës së dhënë nga ligji, pika 5, e nenit 43, dhe pikës 6, të nenit 48 të Ligjit për Statusin.

Në vendimin nr. 320, datë 17.09.2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve”, pika nr. 75 e në vijim të Kreut VI parashikohet se: “Procedura e përzgjedhjes fillon menjëherë pas përfundimit me vendim të formës së prerë të verifikimit të të gjithë kandidatëve dhe, kur është rasti, edhe të vlerësimit etik dhe profesional të tyre. 76. Në procedurën e përzgjedhjes përfshihen të gjithë kandidatët e kualifikuar.”

Ndaj sa më sipër, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur projektvendimin “Për fillimin e procedurave të përzgjedhjes të kandidatëve për lëvizje paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë e Durrës për pozicionet e shpallura të lira, përkatësisht me vendimet nr. 11; 12; 13; 14; 15; 16; 17; 18; 19; 20; 21 dhe 24, datë 18.01.2023.

Po ashtu, sipas këtij projektvendimi, Këshilli do të duhet të caktojë relatorin për çdo procedurë përzgjedhjeje për transferim nëpërmjet lëvizjes paralele. Lidhur me këtë, sipas projektvendimit, Komisioni ka vlerësuar që në rrethanat kur janë 12 pozicione të lira, është propozuar që caktimi i tyre të bëhet për secilën procedurë lëvizjeje paralele, pra një relator për katër pozicione të lirë të lira të shpallura.

Sa i përket relatorëve për secilën procedurë përzgjedhjeje të lëvizjes paralele, ata duhet të zgjidhen me short ndërmjet 3 (tre) anëtarëve të përhershëm të Komisionit për Zhvillimin e Karrierës.

Lidhur me procedurën e shortit, do të jetë ajo e ndjekur në rastet e ngjashme: në një enë të hidhen shiritat e letrës me emrat e anëtarëve të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, dhe në enën tjetër 12 pozicionet ku ka kandidatë të kualifikuar me 2 vlerësime. Më pas, shorti të vijojë me tërheqjen e një prej shiritave të letrës në enën me emrat e anëtarëve të Komisionit, i cili ngarkohet si relator për pozicionin përkatës.

Projektvendimi i propozuar është i strukturuar në 2 pika.

Pika 1 e projektvendimit bën fjalë për fillimin e procedurave të përzgjedhjes të kandidatëve për lëvizje paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë e Durrës për pozicionet e shpallura të lira, përkatësisht me vendimet nr. 11; 12; 13; 14; 15; 16; 17; 18; 19; 20; 21 dhe 24, datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Pika 2 e projektvendimit bën fjalë për caktimin e relatorit, pas zhvillimit të shortit, për secilën procedurë përzgjedhjeje sipas pozicioneve përkatëse.

Së fundi, në projektvendim parashikohet dhe momenti i hyrjes së tij në fuqi, konkretisht menjëherë me botimin e vendimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Kurushi!

Ka diskutime për sa u parashtrua deri tani nga zoti Kurushi para se të fillojmë hedhjen e shortit.

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, administrata të përgatisë shortin sipas mekanizmit të përmendur nga relatori.

Procedura e shortit si vijon:

Futen në enën e parë të qelqit emrat e letrës me emrat e relatorëve sipas kësaj radhe: z. Klodian Kurushi, z. Alban Toro dhe z. Dritan Hallunaj.

Futen në enën e dytë të qelqit shiritat me numrat e pozicioneve sipas radhës: pozicioni nr. 11, pozicioni nr. 12, pozicioni nr. 13, pozicioni nr. 14, pozicioni nr. 15, pozicioni nr. 16, pozicioni nr. 17, pozicioni nr. 18, pozicioni nr. 19, pozicioni nr. 20, pozicioni nr. 21, pozicioni nr. 24.

Procedura e përzgjedhjes si vijon:

Relatori i parë i përzgjedhur nga shorti është z. Klodian Kurushi. Zoti Kurushi do të jetë relator për pozicionet e lira të shpallura me vendimet me nr. 12, nr. 13, nr. 11 dhe nr. 17.

Relatori i dytë i përzgjedhur nga shorti është z. Alban Toro. Zoti Toro do të jetë relator për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 21, nr. 24, nr. 19 dhe nr. 18.

Relatori i tretë i përzgjedhur nga shorti është z. Dritan Hallunaj. Zoti Hallunaj do të jetë relator për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 20, nr. 14, nr. 15 dhe nr. 16.

Ilir Rusi: Faleminderit administratës!

Ka diskutime nga anëtarët për sa u relatua dhe në lidhje me hedhjen e shortit?

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për fillimin e procedurave të përzgjedhjes së kandidatëve për lëvizje paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë e Durrës për pozicionet e shpallura të lira, përkatësisht me vendimet nr. 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21 dhe 24, datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Fillimin e procedurave të përzgjedhjes të kandidatëve për lëvizje paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë e Durrës për pozicionet e shpallura të lira, përkatësisht me vendimet nr. 11; 12; 13; 14; 15; 16; 17; 18; 19; 20; 21 dhe 24, datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Caktimin e relatorit për secilën procedurë përzgjedhjeje për transferim nëpërmjet lëvizjes sipas numrit të pozicioneve të lira të shpallura, si më poshtë:

a) Për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 12, nr. 13, nr. 11 dhe nr. 17 - relator z. Klodian Kurushi.

b) Për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 21, nr. 24, nr. 19 dhe nr. 18 - relator z. Alban Toro.

c) Për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 20, nr. 14, nr. 15 dhe nr. 16 - relator z. Dritan Hallunaj.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 6 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 30.05.2023)

Pika 7 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtim i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, të shpallura me vendimet nr. 22 dhe nr. 23, datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor për kandidatët që kanë ose mund të kenë 1 (një) vlerësim”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).³

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 13:16 dhe mbaroi në orën 15:14.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 4. Irena Plaku | (anëtare) |
| 5. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 6. Ridvan Hado | (anëtar) |

³ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 10-ta sipas rendit të ditës.

7. *Alban Toro* (anëtar)
8. *Marçela Shehu* (anëtare)
9. *Brikena Ukperaj* (anëtare)
10. *Yllka Rupa* (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
2. *Luan Dibra, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
3. *Valbona Bala dhe Oltia Lolo Eksperte (EWMI-NL).*
4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
5. *Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*
6. *Edmond Hoxhaj, BIRN.*

RENDI I DITËS:

7. Shqyrtim i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, të shpallura me vendimet nr. 22 dhe nr. 23, datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor për kandidatët që kanë ose mund të kenë 1 (një) vlerësim”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Ilir Rusi: Në vijim vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, të shpallura me vendimet nr. 22 dhe nr. 23, datë

18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor për kandidatët që kanë ose mund të kenë 1 (një) vlerësim”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit z. Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit!

Relacioni i radhës ka të bëjë me fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, të shpallura me vendimet nr. 22 dhe nr. 23, datë 18.01.2023.

Në vijim, me vendimin nr. 115, datë 13.03.2023, Këshilli ka vendosur: “I. Fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë e Durrës, të shpallura me vendimet e përmendura më lart.

Për z. Vladimir Skënderi, i cili kishte kandiduar për pozicionet nr.11, nr.12 dhe nr.13 të hapura nga Këshilli, u përfundua procedura për këtë kandidat për shkak të tërheqjes së tij nga këto pozicione.

Këshilli me vendime respektive ka përfunduar procedurat e verifikimit për kandidatët që kanë ose mund të kenë 2 (dy) vlerësime. Në përfundim të kësaj vendimmarrjeje është vendosur -Kualifikimi i kandidatit dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në pozicionet përkatëse. I përmenda edhe në relacionin e mëparshëm dhe nuk po i përmend edhe një herë të njëjtët kandidatë.

Këshilli, me vendimin nr. 77, datë 13.02.2023, ndër të tjera ka vendosur: “Miratimin e listës së gjyqtarëve që kanë ose mund të kenë një vlerësim, për efekt të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë e Durrës, të shpallura me vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 11; 12; 13; 14; 15; 16; 17; 18; 19; 20; 21; 22; 23 dhe 24, datë 18.01.2023, sipas Shtojcës II bashkëngjitur këtij vendimi”.

SHTOJCA II

Lista e gjyqtarëve që kanë 1 (një) vlerësim:

1. Znj.{...}, gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, aktualisht komanduar ndihmësmagjistrate në Gjykatën e Lartë

Lista e gjyqtarëve që mund të kenë 1 (një) vlerësim:

1. Z.{...}, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë;
2. Z.{...}, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë;
3. Znj.{...}, gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier;
4. Znj.{...}, gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës;
5. Znj.{...}, gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë;
6. Znj.{...}, gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë (nr.22);
7. Znj.{...}, gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet (nr. 23) – për shkak të suprimimit të vendit është gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan;
8. Z.{...}, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër (nr.22 dhe nr.23);
9. Znj.{...}, gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.

(Kapërcehet gjatë leximit emri i z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin (nr. 23)).

Nga lista e gjyqtarëve të përfshirë në Shtojcën II, rezulton se 4 (katër) prej tyre kanë kandiduar në pozicionet nr. 22 dhe nr. 23. Përkatësisht, znj. {...}, gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë (pozicioni nr.22), Znj.{...}, gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet (pozicioni nr. 23), Z.{...}, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin (nr. 23) dhe {...}, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër (pozicionet nr.22 dhe nr.23).

Në këto kushte, në përputhje me pikën 11 të vendimeve, nr.22 dhe nr. 23, datë 18.01.2023, vendimin nr. 320, datë 17.09.2020, “Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve” të Këshillit, Komisioni i propozon Këshillit të miratojë projektvendimin për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, të shpallura me vendimet nr. 22 dhe nr. 23 datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatët që kanë ose mund të kenë një vlerësim.

Struktura e projektvendimit:

Projektvendimi është i strukturuar në 3 pika.

Në pikën e parë parashikohet fillimi i procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, të shpallura me vendimet nr. 22 dhe nr. 23 datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatët që kanë ose mund të kenë 1 (një) vlerësim.

Në pikën e dytë – caktimin e relatorëve pas zhvillimit të procedurës së shortit për 4 kandidatët të cilët sipas shtojcës II të vendimit nr. 77, datë 13.02.2023, kanë ose mund të kenë 1 (një) vlerësim: Znj. {...}, Znj. {...}, Z. {...}, dhe Z. {...}.

Lidhur me procedurën e shortit, do të jetë ajo e ndjekur në rastet e ngjashme: Në një enë të hidhen shiritat e letrës me emrat e anëtarëve të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, dhe në enën tjetër emrat e 4 (katër) kandidatëve të cilët kanë aplikuar për procedurat e lëvizjes paralele në pozicionet nr.22 dhe nr.23 dhe mund të kenë nga një vlerësim. Më pas, shorti të vijojë me tërheqjen e një prej shiritave të letrës në enën me emrat e anëtarëve të Komisionit, i cili ngarkohet si relator për kandidatin përkatës të zgjedhur në vazhdim tjetër.

Komisioni propozon që secili prej anëtarëve të Komisionit të caktohet relator për 1 (një) kandidat, ndërsa Kryetari i Komisionit caktohet për 2 (dy) kandidatë.

Së fundi, në projektvendim përcaktohet dhe hyrja në fuqi e tij, konkretisht menjëherë dhe shoqërohet me botimin në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Pra për katër kandidatët, dy Kryetari i Komisionit dhe nga një anëtarët e Komisionit. Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Kurushi!

Ka diskutim për sa u relatua deri më tani nga zoti Kurushi?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, administrata të vazhdojë për hedhjen e shortit, duke iu referuar mekanizmit të prezantuar nga relatori.

Procedura e shortit si vijon:

Futen në enën e parë të qelqit shiritat e letrës me emrat e relatorëve sipas kësaj radhe: z. Klodian Kurushi, z. Alban Toro dhe z. Dritan Hallunaj.

Futen në enën e dytë të qelqit shiritat e letrës me emrat e kandidatëve sipas kësaj radhe: znj. {...}, znj. {...}, z. {...} dhe z. {...}.

Procedura e përzgjedhjes si vijon:

Përzgjidhet emri i parë i relatorit, që është z. Alban Toro. Përzgjidhet emri i kandidates, që është znj. {...}. Zoti Toro do të jetë relator për kandidaten znj, {...}.

Përzgjidhet emri i relatorit të dytë, që është z. Dritan Hallunaj. Përzgjidhet emri i kandidatit, që është z. {...}. Zoti Hallunaj do të jetë relator për kandidatit z. {...}.

Përzgjidhet emri i relatorit të tretë, që është z. Klodian Kurushi. Përzgjidhen emrat e kandidatëve, që janë z. {...} dhe znj. {...}. Zoti Kurushi do të jetë relator për kandidatët z. {...} dhe znj. {...}.

Ilir Rusi: Faleminderit!

Ka diskutime nga anëtarët për sa u relatua në lidhje me hedhjen e shortit?

Meqenëse nuk ka diskutime, të vazhdohet me votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, të shpallura me vendimet nr. 22 dhe nr. 23, datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor për kandidatët që kanë ose mund të kenë 1 (një) vlerësim”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, të shpallura me vendimet nr. 22 dhe nr. 23, datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatët që kanë ose mund të kenë 1(një) vlerësim.

2. Caktimin e relatorit si më poshtë:

1. Për kandidaten znj. {...} - relator z. Klodian Kurushi;
2. Për kandidaten znj. {...} - relator z. Alban Toro;
3. Për kandidatin z. {...} - relator z. Klodian Kurushi;
4. Për kandidatin z. {...} - relator z. Dritan Hallunaj;

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 7 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 30.05.2023)

Pika 8 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për kërkesën e gjyqtarës {...} për dhënien leje të papaguar”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Yllka Rupa).⁴

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 13:16 dhe mbaroi në orën 15:14.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 4. Irena Plaku | (anëtare) |
| 5. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 6. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 7. Alban Toro | (anëtar) |
| 8. Marçela Shehu | (anëtare) |
| 9. Brikena Ukperaj | (anëtare) |

⁴ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 12-ta sipas rendit të ditës.

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

2. Luan Dibra, Gentiana Agushi, Maela Alicantaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

3. Valbona Bala dhe Olta Lolo Eksperte (EWMI-NL).

4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.

5. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.

6. Edmond Hoxhaj, BIRN.

RENDI I DITËS:

8. Shqyrtimi i projektvendimit “Për kërkesën e gjyqtares {...} për dhënien leje të papaguar”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore *znj. Yllka Rupa*).

Ilir Rusi: Më tej vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për kërkesën e gjyqtares {...} për dhënien leje të papaguar”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale. Për më tej fjalën relatores *znj. Yllka Rupa*.

Yllka Rupa: Faleminderit zoti Rusi!

{...} është gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm {...}, dhe ka paraqitur kërkesë për dhënie leje të papaguar për periudhën nga data 01.06.2023 deri në datë 01.06.2025, protokolluar në Këshill më datë 23.05.2023.

Më herët, me vendimin nr. 208, datë 20.05.2021, Këshilli ka miratuar kërkesën e saj për dhënie leje të papaguar për arsye familjare për një periudhë 1-vjeçare. Leja e sipërcituar është zgjatur me vendimin nr. 200, datë 31.05.2022, deri më datë 01.06.2023. Shkaqet për të cilën është zgjatur leja, lidheshin me ushtrimin e të drejtës për të krijuar familje.

Në kushtet kur kjo leje përfundon në datë 01.06.2023, gjyqtarja, ka paraqitur përsëri kërkesë për dhënie leje të papaguar për një periudhë 2-vjeçare. Në kërkesën e saj, gjyqtarja kërkon dhënien e lejes prindërore, duke paraqitur si shkak ardhjen në jetë të vajzës së saj më datë 12.04.2023. Gjithashtu, znj. {...}, në kërkesë ka parashtruar se nëse Këshilli vlerëson që nuk plotësohen kriteret ligjore për përfitimim të lejes prindërore, kërkon miratimin e lejes së papaguar për qëllime kualifikimi dhe specializimi, në kushtet kur është pranuar për të ndjekur studimet në një universitet në shtetin e Michigan-it.

Komisioni për Vlerësimin e Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, zhvilloi procedurën administrative në përputhje me parashikimet ligjore dhe brenda 7 ditëve nga depozitimi i kërkesës së gjyqtares, në mbledhjen e datës 29.05.2023 vendosi që kjo çështje t'i kalojë për shqyrtim mbledhjes plenare.

Lidhur me kushtet për dhënien e lejes për arsye prindërore, sipas pikës 5 të Vendimit nr. 72, datë 20.05.2019 “Për lejet e papaguara të gjyqtarëve që jepen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor”, leja prindërore i jepet nga Këshilli gjyqtarit që ka ushtruar funksionin më shumë se një vit të pandërprerë. Nisur nga ky parashikim, znj. {...}, nuk mund të përfitojë leje prindërore të papaguar.

Nga ana tjetër, ndodhur në kushtet ku shkak i kërkesës së saj është bërë ardhja në jetë e fëmijës (vajzës së saj), e cila aktualisht është në moshën 6-javëshe, Komisioni vlerëson së në këtë rast, në respektim të parimit të mbrojtjes së interesit më të lartë të fëmijës, i sanksionuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kodin e Familjes, Legjislacionin e marrëdhënieve të punës dhe atë të sigurimeve shoqërore, leja e papaguar, e kërkuar për këtë arsye, nuk mund të refuzohet.

Parimi i mbrojtjes së interesit më të lartë të fëmijës sanksionohet në nenin 3 të Konventës së Kombeve të Bashkuara (OKB) për të drejtat e fëmijëve në të cilin përcaktohet se: Në të gjitha vendimet që kanë të bëjnë me fëmijën, të marra qoftë nga

institucione publike ose private të përkrahjes shoqërore, nga gjykatat, autoritetet administrative apo organet legjislative, interesi më i lartë i fëmijës duhet të jetë konsideratë parësore. Në respektim të këtij parimi, Kodi i Familjes parashikon dhe rithekson detyrimin për respektimin e interesit më të lartë të fëmijës në një sërë dispozitash të tij ndër të cilat neni 2 parashikon se: “Prindërit, organet kompetente dhe gjykatat, në vendimet dhe veprimtarinë e tyre, duhet të kenë si konsideratë parësore interesin më të lartë të fëmijës”.

Në frymën e këtyre akteve, Kodi i Punës, në nenin 104 të tij përcakton ndalimin e punës për gratë shtatzëna dhe nënat e reja. Nga përmbajtja e kësaj dispozite, qartazi përcaktohet që grave shtatzëna, 35 ditë para lindjes dhe 63 ditë pas lindjes, iu ndalohet të punojnë. Pas përfundimit të kësaj periudhë, gruaja që sapo ka lindur dhe /ose gruaja me fëmije në gjë, vendos vetë nëse do të shkojë në punë.

Duke qenë se jemi në një situatë specifike ku kërkuesja ndodhet në kushtet e përkujdesjes së fëmijës së saj të sjellë në jetë, pra 6-javëshe, por të pamundësisë për t’u trajtuar me leje prindërore për shkak të mospasjes së periudhës 1-vjeçare në marrëdhënie pune, kërkesa e saj do të trajtohet bazuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe dispozitat e mësipërme të Kodi të Punës.

Në analizë të parashtimeve të mësipërme, Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, vlerëson se: gjyqtare {...}, duhet të trajtohet me leje të papaguar për një afat 11-mujor për shkak të lindjes së fëmijës dhe të ushtrimit të së drejtës parësore për të ruajtur dhe garantuar jetën dhe shëndetin e të miturit. Pavarësisht se znj. {...} ka ezauruar periudhën 2-vjeçare të lejes për arsye familjare, gjendja faktike, ardhja në jetë e fëmijës, duhet trajtuar në frymën e garancive kushtetuese për të mbrojtur interesin më të lartë të fëmijës. Në situatën faktike interesi më i lartë i fëmijës dikton kujdesin e pashmangshëm të nënës si në aspektin e nevojave fiziologjike, ushqimit me gjë, ashtu edhe në aspektin e nevojave emocionale të fëmijës dhe nënës gjithashtu. Duke pasur në vëmendje specifikat e lejes së papaguar e cila në thelb aplikohet për të garantuar ruajtjen e vendit të punës për gjyqtarin, gjykohet se për shkak të interesit më të lartë të fëmijës, gjyqtares duhet t’i garantohet e drejta për ruajtjen e pozicionit dhe sigurisht të lejohet të ushtrojë funksionin primar të kujdesit ndaj të miturit.

Pavarësisht gjendjes së sistemit për shkak të vakancave të krijuara, Komisioni vlerëson se, leja e papaguar për gjyqtaren nuk mund të kushtëzohet nga cenimi apo jo i funksionalitetit të gjykatës ku ushtron detyrën gjyqtarja apo nga mendimi me shkrim i zv/kryetares të gjykatës. Gjyqtarja e përfiton këtë të drejtë pa asnjë kusht, derisa fëmija të mbushë 11 muaj.

Megjithatë, nga korrespondenca me Gjykatën e {...}, zv/kryetarja është shprehur që: “Duke mbajtur parasysh arsyet specifike familjare që parashtrohet zonja {...} në kërkesën e vet, fakti që ka vetëm pak muaj që është bërë nënë, mendoj se miratimi i lejes së papaguar nga ana e Këshillit nuk cenon funksionalitetin e gjykatës”.

Komisioni vlerëson se në rastin konkret “leja e papaguar”, nuk përbën “leje prindërore” dhe as zgjatje të afatit të lejes të dhënë më herët për arsye familjare, tej atij 2-vjeçar, të parashikuar nga neni 24 i Ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Këshilli ka detyrimin pozitiv të parashikuar nga neni 54 i Kushtetutës t’i garantojë mbrojtje të veçantë gjyqtares si nënë e re, por edhe fëmijës së sjellë në jetë prej saj. Në referim të neneve 104 dhe 105 të Kodit të Punës, duke përfshirë edhe periudhën 35-ditore para lindjes, kjo mbrojtje nuk mund të zgjasë më shumë se 365 ditë kalendarike, ose më shumë se 11 muaj pas lindjes së fëmijës, në kushtet kur nëna (gjyqtarja) nuk dëshiron të punojë. Nga kjo e drejtë nuk mund të diskriminohen nënat e reja të cilat nuk përfitojnë nga skema e sigurimeve shoqërore (leja e lindjes). Në kushtet kur gjyqtarja kërkon të vazhdojë përkujdesjen për fëmijën e saj të mitur, me qëllim garantimin e interesit më të lartë të fëmijës, Këshilli nuk mund ta refuzojë kërkesën e saj për këtë qëllim, pavarësisht kualifikimit jo të saktë ligjor të bërë në kërkesë si “leje prindërore”. Kjo leje ka natyrën e “lejes së papaguar”, sepse për këtë periudhë gjyqtarja nuk përfiton pagë dhe as të ardhura të tjera nga ligji për sigurimet shoqërore.

Trajtimi i kërkesës së gjyqtares për dhënien e lejes së papaguar për një afat 11-mujor nga lindja e fëmijës, e bën të panevojshëm trajtimin e kërkesës që për të njëjtën periudhë kohore, gjyqtares t’i jepet leje e papaguar edhe për arsye specializimi.

Referuar sa më sipër Komisioni propozon:

1. Miratimin e kërkesës së znj. {...}, gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm {...}, për dhënien e lejes së papaguar për periudhën nga data 01.06.2023 deri në datë 12.03.2024.

2. Njoftimin e këtij vendimi gjyqtares dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm {...}.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit brenda afatit ligjor.

Në lidhje me hyrjen në fuqi të vendimit, duke qenë para një akti individual, akti hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit në referim të nenit 98 pika 2 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Rupa!

Ka diskutime nga anëtarët për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime).

Vazhdojmë me votimin e projektvendimit përkatës.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për dhënien e lejes së papaguar gjyqtares {...}”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Miratimin e kërkesës së znj. {...}, gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm {...}, për dhënie leje të papaguar për periudhën nga data 01.06.2023 deri në datë 12.03.2024.

2. Njoftimin e këtij vendimi gjyqtarës {...} dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm {...}.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrativë të Apelit brenda pesëmbëdhjetë ditëve nga e nesërmja e komunikimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimitetit.

* * *

(Pika 8 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 30.05.2023)

Pika 9 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit z. {...} në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).⁵

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 13:16 dhe mbaroi në orën 15:14.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 4. Irena Plaku | (anëtare) |
| 5. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 6. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 7. Alban Toro | (anëtar) |
| 8. Marçela Shehu | (anëtare) |
| 9. Brikena Ukperaj | (anëtare) |

⁵ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 13-ta sipas rendit të ditës.

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

2. Luan Dibra, Gentiana Agushi, Maela Alicantaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

3. Valbona Bala dhe Olta Lolo Eksperte (EWMI-NL).

4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.

5. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.

6. Edmond Hoxhaj, BIRN.

RENDI I DITËS:

9. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit z. {...} në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

Ilir Rusi: Më tej vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit z. {...} në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit z. Toro.

Alban Toro: Faleminderit!

Atëherë, më herët nga ana e Këshillit, me vendimin nr. 289, datë 30.05.2023 u vendos hapja e procedurës së transferimit të përkohshëm për një pozicion të lirë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, për një afat deri më 30.06.2023. Kjo shpallje i drejtohet gjyqtarit të transferuar, aktualisht në Gjykatën Administrative të

Shkallës së Parë Vlorë, z. {...}, i cili të ftohet për të dhënë pëlqimin për përsëritjen e transferimit të përkohshëm.

Me anë të rrugës elektronike, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i është drejtuar gjyqtarit z. {...} sipas pikës 2 të vendimit nr.289, datë 30.05.2023 duke i përsëritur ftesën për dhënie pëlqimi për përsëritjen e transferimit.

Po në këtë datë gjyqtari z. {...} në rrugë elektronike ka paraqitur një deklaratë ku shpreh pëlqimin për vijim e transferimit të përkohshëm në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë.

Në bazë të nenit 46 të Ligjit nr.96/2016 si edhe nenit 8 të vendimit nr.23, datë 07.02.2019 “Mbi miratimin e Rregullores për kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit”, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i ka kërkuar opinion Kryetarit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër në lidhje me: ngarkesën e gjykatës të cilën drejton në përgjithësi; pasojat që krijohen për gjykatën nga vazhdimi i transferimit të gjyqtarit pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë; si edhe një propozim mbi periudhën maksimale për të cilën gjyqtari kërkohet të transferohet duke marrë në konsideratë efektet negative të shkaktuara nga ky transferim.

Përgjigjja e kryetarit në lidhje me pasojat për gjykatën është si vijon:

Vazhdimi i transferimit të gjyqtarit {...} pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë ka efekte negative për sa i përket buxhetit të gjykatës, pasi, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastër detyrohet t'i paguajë kompensimin për shkak të transferimit në shumën 122,160 (njëqind e njëzet e dy mijë e njëqind e gjashtëdhjetë) lekë të pa planifikuara për pagesë në bazë të Udhëzimit nr.559, datë 29.12.2022 të KLGJ-së. Nisur nga gjendja e buxhetit të Gjykatës Administrative dhe ai i KLGJ mendoj se vazhdimi i transferimit të gjyqtarit do të krijojë pasoja në dhënien e pagave të gjyqtarëve të tjerë dhe të administratës gjyqësore.

Nisur nga afati i përcaktuar për t'u transferuar dy gjykatat administrative, ajo e shkallës së parë Vlorë dhe Gjirokastër, mosvazhdimi i transferimit të gjyqtarit nuk ndikon në shpejtimin e proceseve gjyqësore që ndodhen në shqyrtim apo çështje të reja që do të regjistrohen deri në datën 01.07.2023 në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë. Muaji qershor është muaji i marrjes së masave nga administrata gjyqësore e

secilës gjykate për të filluar punën Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Lushnjë në afatin e caktuar nga KLGJ-ja.

Ky ishte opinioni i kryetarit të gjykatës.

Në vijim, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës duke marrë në konsideratë që nuk mund të aplikohet zbatimi i neneve 45 dhe 46 të Ligjit nr.96/2016, verifikoi plotësimin e kriterëve të kandidaturë që ka dhënë pëlqimin për transferim e përkohshëm por që aktualisht ushtron edhe detyrën e zëvendësit në këtë gjykatë.

Duke vlerësuar ngarkesën aktuale të gjyqtarit që ka shprehur pëlqimin pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, fushën e së drejtës (specifike) që mbulon në këtë gjykatë, cenimin e funksionimit normal, marrë në konsideratë jo vetëm organiken aktuale por edhe numrin e madh të çështjeve, ekzistenca e pozicionit të lira të përkohshëm në të, ngarkesa aktuale Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër ku ai është caktuar në mënyrë të përhershme, KZHK-ja vendosi të miratojë transferimin (zgjatjen) deri në datën 30.06.2023.

Në këtë kuadër është përgatitur relacioni dhe projektvendimi, në dispozitivin e të cilit ju sugjerohet të miratoni:

1. Gjyqtarit {...}, aktualisht gjyqtar në Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër, i përsëritet transferimi i përkohshëm, në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, për një periudhë deri në 30.06.2023.

2. Efektet e vendimit fillojnë nga data 01.06.2023.

3. Njoftimin e këtij vendimi gjyqtarit {...}, Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër dhe Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Toro!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

Klodian Kurushi: Vetëm një diskutim në lidhje me projektvendimin e lexuar nga kolegu. Jam dakord me të gjitha pikat e vëna, por unë do të propozoja që të vihet edhe

një pikë që lidhet me efektet financiare (të pagës) të gjyqtarit. Unë do propozoja të vijonte ai efekt financiar i cili ka ekzistuar me vendimin e parë të transferimit të tij në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë. Në atë kohë efektet financiare përballoheshin nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastrë, kështu që propozimi im është që efektet financiare për pagën e këtij gjyqtari të përballohen nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastrë. Faleminderit!

Ilir Rusi: Ka propozime të tjera?

Nga zoti Kurushi u propozua që të ndryshojë dhe të shtohet një pikë në lidhje me dispozitivin e vendimit, ku pas pikës 2 të jetë pika 3 në të cilën perifrashohet që: Efektet financiare të transferimit të magjistratit z. {...} të përballohen nga Gjykata e Shkallës së Parë Administrative Gjirokastrë; dhe pika 3, kalon pika 4.

Kalojmë në miratimin e këtij propozimi.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Atëherë, kalojmë në miratimin e projektvendimit, bashkë me shtesën e këtij propozimi

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Dakord (*Vota e zonjës Rupa nuk dëgjohet në audio, por e kontaktuar nëpërmjet e-mailit ka konfirmuar (citoj): “Konfirmoj votën pro”. Për efekt të procesverbalit e-maili i konfirmimit të votës i bashkëlidhet procesverbalit të siglosur.*)

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit z. {...} në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Gjyqtarit {...}, aktualisht gjyqtar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë, i përsëritet transferimi i përkohshëm, në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, për një periudhë deri në 30.06.2023.

2. Efektet e këtij vendimi fillojnë nga data 01.06.2023.

3. Efektet financiare të transferimit të gjyqtarit {...} të përballohen nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastrë.

4. Njoftimin e këtij vendimi gjyqtarit {...}, Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë dhe Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 9 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 30.05.2023)

Pika 10 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi miratimin e rregullave standarde për organigramën, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësive të pozicioneve të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë të Gjykatës Administrative të Shkallë së Parë Tiranë”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit (relatore znj. Marçela Shehu).⁶

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 13:16 dhe mbaroi në orën 15:14.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 4. Irena Plaku | (anëtare) |
| 5. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 6. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 7. Alban Toro | (anëtar) |

⁶ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 2-ta sipas rendit të ditës.

8. *Marçela Shehu* (anëtare)
9. *Brikena Ukperaj* (anëtare)
10. *Yllka Rupa* (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*.

1. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
2. *Luan Dibra, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
3. *Valbona Bala dhe Oltia Lolo Eksperte (EWMI-NL).*
4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
5. *Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*
6. *Edmond Hoxhaj, BIRN.*

RENDI I DITËS:

10. Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi miratimin e rregullave standarde për organigramën, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësi të pozicioneve të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë të Gjykatës Administrative të Shkallë së Parë Tiranë”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit (relatore *znj. Marçela Shehu*).

(Përpara trajtimit të katër akteve të fundit, për shkak edhe të rëndësisë që kanë këto akte, anëtarët konsultohen së bashku paraprakisht me to. Më tej rivijon mbledhja.)

Ilir Rusi: Në vijim të mbledhjes vazhdojmë me një pikë tjetër të rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Mbi miratimin e rregullave standarde për organigramën, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësi të pozicioneve të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë të Gjykatës Administrative të Shkallë së Parë

Tiranë”, për të cilin është përgatitur materiali nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit. Për më tej fjalën relatores znj. Shehu.

Marçela Shehu: Faleminderit z. Zëvendëskryetar!

Nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit është paraqitur për shqyrtim mbledhjes plenare projektvendimi “Mbi miratimin e rregullave standarde për organigramën, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësive të pozicioneve të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në përmbushje të përgjegjësive për mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor, në respektim të parimit qeverisës të efikasitetit, administrimit efektiv të gjykatave, dhe sigurimit të mirëfunksionimit të tyre në kuadër të zbatimit të hartës së re gjyqësore, në vijim të procesit të riorganizimit të gjykatave administrative të shkallës së parë Durrës, Korçë dhe Shkodër, harton dhe miraton strukturën organizative dhe organigramën e gjykatës pritëse. Struktura organizative dhe organigrama synojnë rregullimin e funksionalitetit të institucionit/gjykatës, në përcaktim të strukturave funksionale, pozicioneve dhe numrit të tyre, në përputhje edhe me kriteret e veçanta dhe të përgjithshme, në respektim dhe zbatim të detyrimeve kushtetuese e ligjore.

Natyra e aktit dhe harmonizimi i tij me kuadrin ligjor ekzistues.

Aktet e paraqitur për miratim synojnë të përmbushin objektivin strategjik për menaxhimin efektiv të burimeve njerëzore në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë e cila ushtron veprimtarinë në përputhje me kushtet dhe kriteret e përcaktuara në legjisllacionin në fuqi.

Ky objektivi merr rëndësi të veçantë në kuadër të zbatimit të hartës së re gjyqësore, pasi gjykata e riorganizuar do të ketë kapacitetet e nevojshme profesionale për të vijuar ofrimin e shërbimeve në kohën e duhur dhe me cilësi, në referim të pozicioneve të punës.

Pra, struktura organizative dhe organigrama e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lidhet ngushtë me përcaktimin e pozicioneve të punës, numrin e pozicioneve të punës, administrimin efektiv të burimeve njerëzore. Detajimi i

pozicioneve konkrete do të bëhet nga vetë gjykata në bazë të nevojave por duke pasur parasysh numrin total të pozicioneve të punës të trajtuara me dispozita të shërbimit civil apo të Kodit të Punës.

Shpjegim i detajuar i përmbajtjes së aktit:

Aktet e paraqitura, kanë për qëllim, përcaktimin e qartë të strukturave funksionale brenda gjykatës, emërtesës së pozicioneve të punës, në respektim dhe zbatim të vendimeve të KLGJ-së dalë në zbatim të aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, të cilat përcaktojnë numrin e pozicioneve për funksionimin e strukturave (drejtori/sectorë) në institucione, si dhe mbështetur në numrin faktik të punonjësve/nëpunësve pranë gjykatave aktuale.

Grupi Ndërinstitucional i Punës, duke mbajtur në konsideratë, qëllimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor, për sistemim të punonjësve, duke ruajtur numrin total të sistemit gjyqësor 1595 në total (408 gjyqtarë dhe 1187 administratë gjyqësore), por edhe në respektim të akteve ligjore dhe nënligjore për shërbimin civil publik, për aq sa lejohet dhe mundësohet, ka mundësuar hartimin e strukturës organizative dhe organigramës, në analizë edhe të pozicioneve plan-fakt dhe vakancë të gjykatave aktuale.

Sqarojmë se, gjatë hartimit të akteve, është realizuar mbledhje matematikore e administrative të gjykatave aktuale (nëpunës civilë gjyqësorë + punonjës të tjerë gjyqësorë), ku rezultojnë 80 pozicione pune, prej të cilave 8 pozicione pune aktualisht vakantë.

Nga 80 pozicione pune, rezultojnë 60 pozicione të trajtuara me dispozita të ligjit mbi shërbimin civil dhe 20 pozicione pune të trajtuara me dispozita të kodit të punës.

Sa më lartë, në qëndrim të mbledhjes matematikore, do të na rezultonte struktura organizative dhe organigrama me 107 pozicione pune të ndara dhe specifikuar sipas strukturave funksionale, duke mbledhur edhe numrin e gjyqtarëve, 27, referuar vendimit të KLGJ-së për caktimin e numrit të gjyqtarëve.

Në analizë të numrit të personelit aktualisht në detyrë, si edhe më lartë përmendëm rezultojnë 8 pozicione vakante.

Për të realizuar me sukses të gjithë procesin e implementimit të Hartës së Re Gjyqësore, si dhe për qëllim realizimin e funksionimit sipas legjislacionit, të

strukturave të brendshme funksionale të gjykatave, 8 pozicionet vakante aktuale në gjykatat administrative, janë propozuar dhe diskutuar, për të mos u përfshirë në strukturat funksionale të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për t'u vlerësuar për funksionimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë, strukturat e të cilës nuk do të rezultojnë efektive dhe funksionale nga një mbledhje matematike e pozicioneve të punës të dy gjykatave aktuale Vlorë dhe Gjirokastrë.

Pra, aktet e paraqitura për miratim, në një analizë të hollësishme të kryer, përmbajnë një numër prej 99 pozicione pune, sipas edhe rishpërndarjes së këtyre pozicioneve, ku rezultojnë: 27 gjyqtarë; 72 administratë gjyqësore, prej të cilëve: 52 pozicione pune të trajtuara me dispozita të shërbimit civil dhe 20 pozicione pune të trajtuara me dispozita të kodit të punës.

Aktet e propozuar do të zbatohet nga Këshillat aktualë të Gjykatave, nga Komisioni i Ristrukturimit dhe KLGJ, duke u bërë pjesë e rregullave standarde dhe përshkrimeve të pozicioneve të punës.

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Shehu!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Mbi miratimin e rregullave standarde për organigramën, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësive të pozicioneve të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Miratimin e “Rregullave standarde për organigramën dhe përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësive të pozicioneve të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë të Gjykatës Administrative të Shkallës të Parë Tiranë”, sipas tekstit dhe Anekseve bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 10 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 30.05.2023)

Pika 11 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi miratimin e rregullave standarde për organigramën, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësive të pozicioneve të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit (relatore znj. Marçela Shehu).⁷

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 13:16 dhe mbaroi në orën 15:14.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 4. Irena Plaku | (anëtare) |
| 5. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 6. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 7. Alban Toro | (anëtar) |

⁷ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 3-ta sipas rendit të ditës.

8. *Marçela Shehu* (anëtare)
9. *Brikena Ukperaj* (anëtare)
10. *Yllka Rupa* (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*.

1. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
2. *Luan Dibra, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
3. *Valbona Bala dhe Oltia Lolo Eksperte (EWMI-NL).*
4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
5. *Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*
6. *Edmond Hoxhaj, BIRN.*

RENDI I DITËS:

11. Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi miratimin e rregullave standarde për organigramën, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësi të pozicioneve të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit (relatore *znj. Marçela Shehu*).

Ilir Rusi: Më tej vazhdojmë me një pikë tjetër të rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Mbi miratimin e rregullave standarde për organigramën, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësi të pozicioneve të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë”, për të cilin është përgatitur materiali nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit. Për më tej fjalën relatores *znj. Shehu*.

Marçela Shehu: Faleminderit!

Për të mos u tej zgjatur unë do të ndalem vetëm në momentet ndryshe që lidhen me projektvendimin “Mbi miratimin e rregullave standarde për organigramën, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësive të pozicioneve të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë”. Pra të ndalemi vetëm tek veçorit e këtij akti, pasi pjesa tjetër u ezaurua në relacionin në lidhje me Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Në lidhje me Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë, Grupi Ndërinstitucional i Punës, duke mbajtur në konsideratë, qëllimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor, për sistemim të punonjësve, duke ruajtur numrin total të sistemit gjyqësor 1595 në total, por edhe në respektim të akteve ligjore dhe nënligjore për shërbimin civil publik, për aq sa lejohet dhe mundësohet, ka mundësuar hartimin e strukturës organizative dhe organigramës, në analizë edhe të pozicioneve që janë në plan dhe vakancat sot.

Sqarojmë se, gjatë hartimit të akteve, është realizuar mbledhje matematikore e administrative të gjykatave aktuale, ku rezultonin 26 pozicione pune, si dhe janë shtuar 8 pozicione pune aktualisht vakantë të marrë nga gjykatat (siç e relatova pak më parë), nga gjykatat administrative të shkallës së parë Korçë, Shkodër dhe Durrës, për të pasur kështu efektiv strukturat funksionale.

Nga 26 pozicione pune plan, rezultojnë 18 pozicione të trajtuara me dispozita të ligjit mbi shërbimin civil dhe 8 pozicione pune të trajtuara me dispozita të kodit të punë.

Sa më lartë, në qëndrim të mbledhjes matematikore, do të na rezultonte struktura organizative dhe organigrama me 26 pozicione pune të ndara dhe specifikuar sipas strukturave funksionale, duke mbledhur edhe numrin e 8 pozicioneve vakante, do të konkludojmë në një strukturë organizative me 34 pozicione pune, pa numrin e gjyqtarëve.

Për të realizuar me sukses të gjithë procesin e implementimit të Hartës së Re Gjyqësore, si dhe për qëllim realizimin e funksionimit sipas legjislacionit, të strukturave të brendshme funksionale të gjykatave, 8 pozicionet vakante aktuale në gjykatat administrative të sipërcituara, janë propozuar për t’u përfshirë në strukturën funksionale të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë, për funksionimin e kësaj

gjkate, strukturat e të cilës nuk do të rezultonin efektive dhe funksionale nga një mbledhje matematike e pozicioneve të punës të dy gjykatave aktuale Vlorë dhe Gjirokastër.

Pra, aktet e paraqitura për miratim, në një analizë të hollësishme të kryer, përmbajnë një numër prej 43 pozicione pune, sipas edhe rishpërndarjes së këtyre pozicioneve, ku rezultojnë: 9 gjyqtarë; 34 administratë gjyqësore, prej të cilëve: 26 pozicione pune të trajtuara me dispozita të shërbimit civil dhe 8 pozicione pune të trajtuara me dispozita të kodit të punës.

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Shehu!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime.)

Atëherë kalojmë në votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Mbi miratimin e rregullave standarde për organigramën, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësi të pozicioneve të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Miratimin e “Rregullave standarde për organigramën dhe përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësi të pozicioneve të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve

të tjerë të Gjykatës Administrative të Shkallës të Parë Lushnjë”, sipas tekstit dhe Anekseve bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 11 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 30.05.2023)

Pika 12 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për rishpërndarjen e numrit të pozicioneve të punës në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit (relatore znj. Marçela Shehu).⁸

Pika 13 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për rishpërndarjen e numrit të pozicioneve të punës në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit (relatore znj. Marçela Shehu).⁹

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 13:16 dhe mbaroi në orën 15:14.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
- 2. Klodian Kurushi*** (anëtar)

⁸ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 4-ta sipas rendit të ditës.

⁹ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 5-ta sipas rendit të ditës.

- | | |
|---------------------------|------------------|
| 3. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 4. Irena Plaku | (anëtare) |
| 5. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 6. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 7. Alban Toro | (anëtar) |
| 8. Marçela Shehu | (anëtare) |
| 9. Brikena Ukperaj | (anëtare) |
| 10. Yllka Rupa | (anëtare) |

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, **znj. Naureda Llagami.**

- 1. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 2. Luan Dibra, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 3. Valbona Bala dhe Olta Lolo Eksperte (EWMI-NL).**
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.**
- 5. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.**
- 6. Edmond Hoxhaj, BIRN.**

RENDI I DITËS:

12. Shqyrtimi i projektvendimit “Për rishpërndarjen e numrit të pozicioneve të punës në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit (relatore znj. Marçela Shehu).

13. Shqyrtimi i projektvendimit “Për rishpërndarjen e numrit të pozicioneve të punës në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit (relatore znj. Marçela Shehu).

Ilir Rusi: Më tej vazhdojmë me një pikë tjetër të rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për caktimin e numrit të pozicioneve të punës në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë”, për të cilin është përgatitur materiali nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, me relatore znj. Shehu.

Marçela Shehu: Faleminderit!

Atëherë, nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit i janë paraqitur për shqyrtim mbledhjes plenare edhe dy projektvendime, konkretisht projektvendimi “Për caktimin e numrit të pozicioneve të punës në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë” dhe projektvendimi “Për caktimin e numrit të pozicioneve të punës në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë”.

Të dy këto akte kanë si qëllim ndarjen dhe evidentimin e pozicioneve të punës të atyre punonjësve që kanë status të nëpunësit civil dhe atyre që trajtohen me kod pune, sipas listës bashkëngjitur.

Ilir Rusi: Atëherë, për sa u relatua nga zonja Shehu, u relatua edhe pika tjetër e rendit të ditës që është edhe pika e fundit e kësaj mbledhjeje për ditën e sotme, që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për caktimin e numrit të pozicioneve të punës në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë”, për të cilin është përgatitur materiali përkatës nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit dhe u relatua nga zonja Shehu.

Fillimisht miratojmë projekt-aktin në lidhje me caktimin e numrit të pozicioneve të punës në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë (të riorganizuar).

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për caktimin e numrit të pozicioneve të punës në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Caktimin e numrit të pozicioneve të punës së Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, sipas shtojcës nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, të bëjë detajimin e pozicioneve të punës në mbështetje të numrit të përcaktuar dhe nevojave.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Vazhdojmë me votimin e projektvendimit tjetër që ka të bëjë me “Për caktimin e numrit të pozicioneve të punës në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë”.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për caktimin e numrit të pozicioneve të punës në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Caktimin e numrit të pozicioneve të punës së Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë, sipas shtojcës nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

* * *

(Pikat 12 dhe 13 të rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor